



Prishtinë, 27 nëntor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1204_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 11, 12, 13, 15 dhe 17 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-081);
- Vendimin e Këshillit Ministor të Komunitetit të Energjisë Nr. D/2012//MC-EnC, për caktimin e konsumit të energjisë të detyrueshëm nga burimet e ripërtritshme deri në vitin 2020;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017 për caqet e Burimeve të Ripërtritshme të Energjisë, të datës 23.06.2017, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
- Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2017 për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e Ripërtritshme, të datës 07.08.2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Rregullën Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme të Energjisë;
- Rregulla për vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal;
- Rregulla për të hyrat e lejuara maksimale për operatorin e sistemit të transmisionit dhe të tregut;
- Rregullën Nr. 11/2017 për Procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja buazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Raportin Konsultativ për trajtimin e caqeve shtesë të BRE-ve dhe mekanizmat e mbështetjes(20MW solare fotovoltaike);
- Përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit-Mekanizmi e mbështetjes për caqet shtesë të BRE-ve (20MW solare fotovoltaike);dhe
- Dispozitivin e pikës VII., të Vendimit V_810_2016 të datës 19.05.2016 për përcaktimin e tarifave nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtritshme,

në seancën e mbajtur më 27 nëntor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **PËRCAKTOHET** – Tarifa nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, vetëm për caqet shtesë prej 20 MW sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë Elektrike.
- II. **Tarifa Nxitëse (Feed in)** vlen për kapacitetet e instaluar gjeneruese me pajisje të reja (me zero operim), dhe pajisjet e paneleve solare/fotovoltaike duhet të jenë të riciklueshme.
- III. ZRRE do t'i njoftoj aplikuesit të cilët janë të pajisur me Autorizim Preliminar të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, dhe të cilët janë në listën e pritjes sipas rendit kronologjik të lëshimit të vendimeve, për tu përfshirë në skemën mbështetëse për caqet e disponueshme.
- IV. Tarifa Nxitëse për energjinë solare fotovoltaike është përcaktuar sipas Metodologjisë për llogaritjen e tarifës nxitëse për energjinë solare fotovoltaike- Raporti konsultativ i lëshuar me datë 02.05.2019.
- V. Niveli i caqeve të përcaktuara për panelet solare/fotovoltaike dhe të pranuar në skemën mbështetëse do të jetë si në vijim:

Tabela1: Kapacitetet e reja sipas caqeve të përcaktuara për panelet solare/fotovoltaike

| Kapaciteti i Energjisë elektrike të prodhuar nga BRE | |
|--|----|
| Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme | MW |
| Energjia fotovoltaike | 20 |

- VI. Tarifa nxitëse (Feed in) e përcaktuar për panelet solare/fotovoltaike nga Burimet e ripërtëritshme të Energjisë do të jetë si në vijim:

Tabela2: Tarifa nxitëse (Feedin) e aplikueshme për panelet solare/fotovoltaike dhe të pranuar në skemën mbështetëse

| Tarifa nxitëse e aplikueshme për energjinë solare | |
|---|-------|
| Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme | €/MWh |
| Energjia solare/fotovoltaike | 85.5 |

- VII. Tarifa nxitëse (feed in) e përcaktuar në dispozitivin nën pikën V., të këtij Vendimi do të vlejnjë vetëm për nivelin e caqeve të vendosura në Tabelën 1 dhe çdo ndryshim i nivelit të caqeve të BRE-ve, do të trajtohet sipas legjislacionit të aplikueshëm në fuqi.
- VIII. Kufizimet e kapaciteteve instaluese nga panelet solare/fotovoltaike për pranim në skemën mbështetëse është si në vijim:

Tabela3: Kufizimi i planifikuar në MW i aplikacioneve që do të pranohen në skemën mbështetëse sipas burimit primar të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme

| Kufizimi i kapaciteti për pranim në skemën mbështetëse | |
|--|---------------|
| Burimi primar i energjisë së ripërtëritshme | Kapaciteti MW |
| Energjia solare/fotovoltaike | 3MW(≤3MW) |

- IX. Tarifa nxitëse (Tabela 2) do të vlejë vetëm për aplikuesit të cilët janë të pajisur me Vendim mbi Autorizimin Preliminar të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, sipas kronologjisë së lëshimit të vendimeve, për cakun deri në 20 MW.
- X. Marrëveshja për Blerje të Energjisë nga panelet solae /fotovoltaike për caqet sipas këtij vendimi, do të ketë kohëzgjatje dymbëdhjetë (12) vjeçare, me çmim (tarifën nxitëse) të aplikueshme sipas dispozitivit nën pikën VII. të këtij vendimi.
- XI. ZRRE do t'i konsideroj caqet e përmbushura për panelet solare/fotovoltaike, atëherë kur janë lëshuar Vendimet për Autorizime Preliminare me kapacitetin e instaluar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për caqet e BRE-ve deri në vitin 2020.
- XII. Aplikuesit të cilët posedojnë Vendime për Autorizimin Preliminar me vërejtje nga Bordi i ZRRE, sipas Nenit 4 paragrafi 9 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse, afati i përcaktuar me Rregullën e Procedurës së Autorizimit, do të fillojë të rrjedhë, jo nga data e lëshimit të vendimit përkatës, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në Skemën mbështetëse sipas rendit kronologjik të lëshimit të vendimeve.
- XIII. Në rast se aplikuesi ka Vendim për Autorizimin Preliminar për kapacitetin më të lart se caqet e liruara, aplikuesi do të ketë të drejtën të kërkojë që Vendimi për shëndrrimin e Autorizimit Preliminar në Autorizim Final të modifikohet/ndryshohet në atë mënyrë që i garantohet e drejta për caqet e liruara, ndërsa kapaciteti i mbetur mund të vazhdojë të jetë "në pritje", sipas kërkesës së aplikuesit.
- XIV. Aplikuesit të cilët i tejkalojnë kapacitet e instaluar gjeneruese sipas këtij vendimi (tabela 3) dhe të cilët janë të përfshirë në skemën "në pritje" sipas vendimeve përkatëse të lëshuara nga Bordi i ZRRE-së, nuk do të pranohen në Skemën Mbështetëse e as nuk u takon tarifa nxitëse.
- XV. Aplikuesit të cilët posedojnë Vendime për Autorizime Preliminare që janë përtej caqeve prej 20 MW, do të vazhdojnë të mbeten në skemën mbështetëse "në pritje", dhe do të trajtohen sipas dispozitave ligjore të Rregullës Nr. 05/2017 për Skemën Mbështetëse të ZRRE-së.
- XVI. Ky vendim vlen vetëm për caqet shtesë prej 20 MW sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa për rastet tjera nuk aplikohet.
- XVII. Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të Raportit Konsulltativ dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- XVIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- XIX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



Arsim Janova, u.d. kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Rrshiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KOSTT,
- Palëve, dhe
- Arkivit të ZRRE-së